

Angazhohu Monitoro Veopro



SUPLEMENT I GAZETËS NOSITI NGA GRUPI MONITORUES I TË RINJVE
POGRADEC, MAJ 2015 ÇMIMI 20 LEKË

T'i imponohemi Pushtetit Vendor me intonacionin rinor!



ANGAZHOHU - MONITORO - VEPRO	faqe 2
SA TË BARABARTË E DUAM BOTËN	faqe 3
RRUGËTIMI I LIDERSHIPIT	faqe 4
TË JESH LIDER	faqe 5
EDUKIM PËR FUQIZIMIN E TË RINJVE	faqe 6
JETA BOSHE E TË RINJVE	faqe 6
BUZËQESHJA E TOKËS VARET NGA NE	faqe 7
NEVOJAT DHE PROBLEMET E TË RINJVE	faqe 7
PSIKOLOGJI	faqe 8

**ZGJIDHNI QUITZ NË FAQEN 3 DHE MERRNI NJË
DHURATË NGA GRUPI MONITORUES**

Ne ishim vullnetarët e parë pranë shoqatës “Unë, Gruaja”. U rritëm së bashku dhe u bëmë lidera. Sot ne jemi trajnerët e projektit: “Më shumë të rinj në Leadership nëpërmjet pjesëmarrjes qytetare”. Shumë të rinj pogradecarë i janë bashkuar nismës sonë, për të qenë të suksesshëm në jetë, për të marrë përgjegjësi dhe sfida qytetare. Ata nesër do të jenë liderat e së ardhmes.



**Bëhu
edhe
TI
Lider!**

Apliko tani pranë shoqatës “Unë, Gruaja”, Pogradec. Telefono 08322 2140

Angazhohu - Monitoro - Vepra

Përfaqësimi i një grupi njerëzish të një zone territoriale të caktuar në nivel vendor, ka një rëndësi të veçantë në të mirë të atij komuniteti. Çdokush që voton për një subjekt të caktuar politik dhe jo vetëm, duhet të dijë si dhe nga kush përfaqësohet në organizimin e qeverisjes vendore. Po a është produktive mënyra aktuale e përfaqësimit?

Personalisht mendoj se jo, shumica e njerëzve nuk e dinë se nga kush përfaqësohen dhe si përfaqësohen. Në Kodin Zgjedhor përcaktohet qartë se si zgjidhen këshilltarët e një organi vendor, subjekti politik paraqet një listë shumëmemërore pranë KQZ-së dhe sipas modelit mazhoritar, ku në bazë të votave të marra, përpjesëtuar me numrin e këshilltarëve, përcaktohet numri fitues i këshilltarëve. Nga kjo mënyrë del një përfaqësi këshilltarësh nën siglën e një partie, duke përfaqësuar interesat e qytetarëve, të cilët i kanë zgjedhur me anë të votës, por a përfaqësohen vërtet interesat e qytetarëve?

Mbledhjet e Këshillit të Bashkisë Pogradec, por edhe në gjithë Shqipërinë, në bazë të legjislacionit mbi organizimin e qeverisjes vendore mblidhen një herë në muaj. Për përcaktimin e rendit të ditës zhvillohet mbledhja paraprake për diskutimin dhe miratimin e ligjeve të ndryshme që bëhen gati për t'u votuar, hartohen dhe bëhen gati nga një komision i posaçëm, i cili ia paraqet Këshillit për votim.

* * *

Në mbledhjen e fundit të Këshillit Bashkiak Pogradec, që me fillimin e saj u vu re një vonesë e vogël. Edhe pse me vonesë numri i antarëve të këshillit ishte jo i plotë, kishte një mungesë prej 8 anëtarësh, ku 4 prej tyre ishin nga dy partitë e mëdha, dy nga PS dhe dy nga PD. Jo pa qëllim përmenda dy partitë e mëdha, sepse

edhe pse rëndësia e këshilltarit është e njëjtë, janë dy parti, të cilat duhet të kenë një seriozitet më të lartë ndaj prezencës dhe përfaqësimit qytetar. Mes problemeve të para, kryetari i Këshillit të Bashkisë Pogradec, z. Eduart Kapri deklaroi hapjen e mbledhjes duke lexuar pikat mbi rendin e ditës për diskutim dhe votim.



Pjesëmarrja nga Kryetari i Bashkisë Pogradec ishte korrekte, ku me kërkesë të tij u shtua një pikë tjetër mbi rendin e ditës, e cila u votua nga këshilli.

Në rendin e ditës ishin tre pika :

1-Projekt-vendim "Për një ndryshim në përbërjen e Këshillit të Bashkisë Pogradec"

2-Projekt-vendim "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1-31 Mars 2015"

3-Projekt-vendim "Për përfaqësuesin e Këshillit të Bashkisë Pogradec në Asambleenë e Aksionerëve të UK sh.a dhe të Drejtat e Përfaqësimit"

Personat më aktivë në këtë mbledhje dhe që morën pjesë në diskutim ishin z.Guri Ademaj PS, znj.Natalja Velo, z. Hasan Laho, z. Eduart Kapri, z.Syrja Palla dhe pjesa tjetër ishte një dëgjues i mirë (mund të them që mezi po prisnin që të iknin). Për vetë funksionin e Këshillit të Bashkisë është e domosdoshme pjesëmarrja e Kryetarit të Bashkisë, drejtorët e drejtorive,

si dhe specialistët përkatës për ligje dhe vendime që merren gjatë mbledhjes.

Pjesëmarrja e tyre në këtë mbledhje ishte thuajse e plotë, me vetëm një mungesë. Debatu u përqëndrua kryesisht në pikën tre, ku në gjykimin tonë ishte e drejtë që hezitohet të pranohet nga shumica e anëtarëve të këshillit.

Duhet përhëndetur propozimi i z.Eduart Kapri, për rishikimin e tabelave të ndërmarrjes UK sh.a, ku vërtet duhet të bëheshin korrigjime, gjë e cila u pranua dhe nga vetë përfaqësuesi i UK sh.a - drejtori dhe nëndrejtori.

Por në këtë kundërshtim edhe pse i drejtë me ligjin, përshtypje të madhe bënte hedhja kundër e anëtarëve, të cilët dukeshin hapur që po mbështetnin interesat klienteliste dhe jo ato të qytetarëve që vërtet duhet të përfaqësojnë.

Ajo që u vu re ishte thyerja e mbledhjes me hyrje-dalje nga salla, jo vetëm për komunikime në telefon, por edhe për të pirë ndonjë cigare apo për t'u këshilluar mbi votimin e ndonjë çështjeje në zhvillim e sipër. Ky seriozitet i munguar tregon haptazi një indiferencë mbi çështjet dhe problematikat me karakter publik.

Një kërkesë nga ana e një kryefamiljareje, me dy fëmijë dhe e divorcuar, për të përfituar ndihmë ekonomike, u përcaktua nga këshilli që të diskutohet në mbledhjen e radhës, pasi aplikuesja të paraqiste dokumentacionin e nevojshëm.

Ndoshta burokracitë e tilla, mund të zgjidhen me asistencën e një administratori të Zyrës së Ndihmës Ekonomike, sepse mendoj që nëna pa të ardhura ekonomike, ndoshta nuk zotëron informacionin e duhur... edhe pse kjo e fundit, duhet të ndërgjegjësohet, për të marrë pjesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, të paktën për rastin kur shqyrtohet kërkesa e saj, duke shfrytëzuar mundësinë e diskutimit dhe mbrojtjes së rastit. Të shohim mbledhjen e radhës si do të procedohet!



Monitoruesit

Këshilli Bashkiak - Pogradec

- Zhuljen Manellari
- Diter Bitri
- Sergej Meçe
- Enxhi Kaso
- Simela Gegprifti

Sa të barabartë e duam botën

Sa e madhe është bota dhe sa të ndarë jemi të gjithë ne. E fillova me këtë fjali, e cila për shumë persona mund të konsiderohet edhe hipotezë, ndërsa për dikë realitet, por gjithçka mbetet të shihet në konturet e asaj që nënkupton bota me termin "barazi". Nëse fillesat tona për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje do të ishin nga fjalori i gjuhës shqipe (sepse nëse nuk nisemi nga vetvetja dhe gjuha jonë, atëherë nga t'ia fillojmë?), sipas fjalorit, barazia do të përkufizohej si ndjenja e të qenit i barabartë në "madhësi", "shkallë" dhe "cilësi". Gjendje e barabartë e njerëzve në shoqëri, të cilët kanë të drejta të njëjta politike e qytetare, apo të drejta për të qenë të barabartë. Është fakt që teoritë e shumta mundohen të tregojnë për barazinë në aspekte të ndryshme, edhe pse nga një këndvështrim sipërfaqësor, këto teori nuk janë të pranishme në realitetin tonë.

Mund të jenë të habitshme përgjigjet e qytetarëve rreth pyetjes sesa të barabartë e dëshirojnë ata mjedisin ku jetojnë,

sepse vetë barazia është një koncept i kontestuar. Ka botëkuptime të ndryshme, ku disa njerëz e mbrojnë me fanatizëm atë si të ishte një virtut i çmuar dhe njerëz konservatorë në veprime e mendime. Më tepër se thjesht një gjendje, barazia nënkupton korrespondencën dhe lidhjen e fortë midis moralit dhe gjykimit (sipas Albermety "Historia e konceptit" 1959). Ashtu si edhe dukuria e rimishërimit ashtu edhe barazia është e shkrirë në shumë trajta e forma. Barazi si qytetar, barazi pavarësisht influencës, barazi racore e ajo gjinore. Të gjithë ne e dëshirojmë me ngulm ndryshimin, por kur na drejtohet pyetja se sa të gatshëm jemi për të ndryshuar, të gjithë bëjnë një hap pas, ashtu si nxënësit e papërgatitur në një orë mësimi, mundohemi të fshihemi pas shpinës së shokut për t'i humbur shikimit të mësueses, pa e kuptuar rëndësinë e atij shikimi.

Duke kaluar në raste më tepër specifike, të cilat kanë lidhje me terrenin tonë, vlen të përmendim punën e realizuar nga Top Channel, në Prill të 2015-ës, duke pasqyruar kështu tablonë e trishtueshme të akteve publike ndaj pabarazisë racore, duke shfaqur indiferencën e theksuar të popullit shqiptar ndaj akteve të papranueshme të diskriminimit. Duke ditur se në çdo vend dielli lind në mëngjes,

shumë pak e kuptojnë që dielli lind në këtë mënyrë të barabartë për të gjithë, fillesa dhe thelbi i shoqërisë sonë, që është familja, nuk përkon me këtë realitet, sepse dielli nuk lind në mënyrë të barabartë në familjet shqiptare. Sipas një studimi të bërë në vitin 2007, me titull "Gratë dhe Fëmijët në Shqipëri", pjesëmarrja e gruas në tregun e punës ra ndjeshëm pas viteve 90-të, nga 78% në 1989 në 46% në 2005. Por kjo nuk është e mjaftueshme, pasi duke ditur se popullsia e Shqipërisë është rreth 3 milionë banorë, prej të cilëve 1 milionë e 409 mijë e 931 janë femra (ose 49.8 përqind) dhe nëse të papunësuarat janë 46% e tyre, atëherë duke bërë një përlllogaritje janë afërsisht rreth 600 mijë femra të papuna. Grupmoshat që përjetojnë më tepër dhunë janë 18 - 23 vjeç dhe 37- 45 vjeç, ndër të cilat më të rrezikuara janë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, gratë dhe vajzat emigrante, gratë dhe vajzat rome, si dhe gratë e vajzat e zonave rurale. E gjithë kjo statistikë është sipas Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje.

Duke përfunduar kështu, edhe pse natyra i ka bërë njerëzit e barabartë, vetë njeriu e ndryshon këtë rrjedhje, duke i bërë disa individë më të barabartë se të tjerët. Jo vetëm në Shqipëri, por në gjithë botën ekziston fenomeni i pabarazisë dhe kjo jo vetëm pabarazi gjinore, e përmendur më sipër, sepse pabarazitë shkaktohen



edhe në raport me etninë, racat apo religjionet. E gjithë bota është e ndarë në Veri dhe Jug, në të pasur dhe varfëri ekstreme. Duke ditur që në çdo tre sekonda vdes nga një fëmijë për shkaqe të mosushqyerjes në vendet e varfra dhe në po ato tre sekonda bota e pasur shpenzon 75 mijë dollarë vetëm për forcat ushtarake, kjo tregon pabarazi në të gjitha aspektet shoqërore. Por, duke shpresuar se do të vijë koha e thënies së presidentit të tretë të Amerikës, Tomas Xheferson, i cili citohet të ketë thënë: "Të drejta të barabarta të gjithëve, privilegje të veçanta asnjërit", apo thënia nga ekonomisti amerikan, Robert Shiller: "Barazia e të drejtave është ligji i shenjtë i njerëzimit", vetëm me realizimin e këtyre dy parimeve, mund të themi të bindur se barazia ka qenë e pranishme dhe është jetuar në botë.


Ina Beçoku



QUITZ informues

- Si quhet ministri përgjegjës për implementimin e reformës administrative-territoriale?
- Cili është numri i qarqeve që do të funksionojnë pas reformës/zgjedhjeve lokale?
- Cili është numri i bashkive që do të funksionojnë pas reformës/zgjedhjeve lokale?
- Kur nis nga puna Këshilli i Bashkisë, pas zgjedhjeve lokale?
- Sa do të jetë numri i këshilltarëve në Këshillin Bashkiak të Pogradecit?
- Sa prej kompetencave apo funksioneve të pushtetit vendor do të ndryshojnë dhe cilat janë ato?
- Si do të realizohet decentralizimi i pushtetit (kompetencave) pas implementimit të reformës/zgjedhjeve lokale?
- Si do të realizohet korrespondenca zyrtare ndërmjet njësive të qeverisjes vendore, sipas secilës shkallë të pushtetit vendor?

Përgjigjet e sakta dërgojini me email une_gruaja@yahoo.com, ose FB: shoqata Une, Gruaja. Fituesi shpërblehet me...



Mrugëtimi i lidershypit



Projekti **“Të Zgjerohet Rrathët nëpërmjet Lidershypit dhe Pjesëmarrjes së të Rinjve”**, organizuar nga Shoqata “Unë, Gruaja” dhe mbështetur nga “Komisioni i Granteve të Vogla”, Seksioni i Punëve të Jashtme, Ambasada Amerikane Tiranë, ishte eksperiencia më e vyer për mua, por besoj edhe një pasurim i axhendës dhe përvojës për të rinjtë e aktivizuar.

Risia në këtë program trajnimi qëndroi te përbërja e grupit, sepse në 6 seancat e planifikuara morën pjesë të rinj të pozicionuar tashmë në role drejtuese si: kryetarë, zv/kryetarë dhe aktivistë të Forumeve Rinore të Partive Politike që operojnë në qytetin e Pogradecit; kryetarë, nën/kryetarë, koordinatorë dhe aktivistë të Qeverive të Nxënësve të disa gjimnazeve në Pogradec, duke përmendur këtu edhe të rinj të vetëpunësuar dhe aktivistë nga Shoqëria Civile.

Trajnimi synoi nxitjen e të rinjve në vendimmarrjen politike dhe përgatitjen për të qenë sa më kontribues në komunitet dhe shoqërinë civile, pse jo edhe lider. Të gjithë pjesëmarrësit do të pajisen në Ceremoninë Përmbyllëse me Certifikatë nga organizatorët e mësipërm, si edhe të rinjtë më aktivë të këtij trajnimi, do të përzgjidhen dhe do të vijojnë me trajnimet për t’u angazhuar vullnetarisht, por edhe me pagesë, sipas kontributit, në shërbimet e mëposhtme:

- Monitorues të zgjedhjeve lokale
- Monitorues të mbledhjeve të Këshillit



Bashkiak

- Botues të një buletini mbi monitorimet
- Trajnues të grupit pasues
- Pjesëmarrës në projektet e radhës së Shoqatës “Unë, Gruaja” - Pogradec.

Seancat u zhvilluan mesditët e shtuna, duke filluar nga data 28/02/2015, deri në momentet që flasim, pasi grupi i të trajnuarve realizoi me përpikmëri të gjitha ushtrimet praktike (njëra prej të cilave ishte pikërisht botimi i këtij buletini) dhe janë në koordinim të punëve për të kryer aktivitete të larmishme për komunitetin, mbi të cilat do të informoheni në kohën e duhur, pse jo edhe të na bashkoheni për të qenë bashkëpunorë të këtyre iniciativave rinore me rëndësi për qytetin tonë.

Programi dhe aktivitetet e këtij trajnimi janë të shumta, por po ndaj me ju vetëm temat kryesore dhe disa prej nënçështjeve të trajtuara: *Përse Lider?; Parimet e Lidershypit; Ndërrimi i pozitave dhe vlerësimi i vendimmarrjeve të gjithsecilit; Afeksioni grupor dhe planifikimi i punës (ushtrimi praktik i pastrimit të qytetit); Komunitarizmi dhe Vullnetarizmi; Rëndësia e Pjesëmarrjes në Vendimmarrje; Risku i Lidershypit & Problemet Sociale Bashkëkohore; Nënvizimi i rëndësisë së*

Do të diferencojë konsiderueshëm realizimin e suksesshëm të detyrave praktike, si pastrimi i qytetit (propozuar nga anëtarë i grupit Zhuljen Manellari, i cili është aktualisht Kryetar i FRESSH-it për rrethin e Pogradecit), si edhe Aksionin e Fjalës së Lirë - gjatë kësaj tryeze diskutimi, të rinjtë e trajnuar demonstuan nga një fjalim simulant mbi projektidetë me fokus zhvillimin dhe gjallërimin e jetës rinore, duke realizuar kështu edhe ushtrimin praktik të planifikuar gjatë trajnimeve,



pas kalimit të ushtrimit të parë të dhënies së intervistave. Duke përgëzuar aktivizimin e profesionist të televizionit lokal Sot7, staf i cili na asistoi dhe publikoi secilin zhvillim në funksion të trajnimit.

Pjesëmarrja tek të dyja aktivitetet ishte masive dhe ajo që konstatoj nga të gjitha



bashkëpunimit dhe matjes së performancës në grup; parashikimi i sjelljeve dhe drejtimi efektiv; Njohja dhe kuptimi i larmishmërisë së Problemeve Sociale; Fjalimi Publik; etj.

seancat e trajnimit dhe bashkëpunimi me grupin është se ka ende një dëshirë të zjarrtë për të dhënë kontributin tonë modest në drejtim të zhvillimit dhe vlerësimit të jetës aktive pogradecare. Një jetë rinore që mendon se nuk e ka mbështetjen dhe vëmendjen nga pushteti vendor, qendror apo organizma ndërkombëtarë, por nëse kërkojmë aleatët e duhur – si shoqata “Unë, Gruaja” Pogradec, llojmë fort për projektet tona dhe kalitim dëshirat për sukses me vullnetin e përfshirjes në vendimmarrje dhe frymën e bashkëpunimit, atëherë situata nuk reflekton zymtësinë që proklamojmë, por ndez alarmin për punë të palodhur dhe shpërblime të merituar.

Dorian Leka

Të jesh lider



Të flasësh për leadershipin nuk është aspak e lehtë, pasi përfshin një larmishmëri karakteristikash. Gjatë këtij trajnimi të zhvilluar nga shoqata “Unë, Gruaja”, në bashkëpunim me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, morën pjesë një grup të rinjsh nga komuniteti ku unë bëj pjesë, të cilët demonstruan se me vullnet, kohë dhe bashkëpunim, e pamundura bëhet e mundur.

Trajnimi “Bëhu lider” (i cili zgjati rreth pesë seanca, me një itinerar kohor afërsisht 2 orë, që nga data 28 mars dhe deri në 12 prill) kishte si qëllim integrimin dhe përfshirjen e të rinjve në aktivitete të tilla, të cilat me kalimin e kohës do të mundet t’i orientojnë se si mund të hedhin hapat e para drejt themeleve për të ndërtuar një lider të kompletuar në të gjitha aspektet.

Shpesh ndodh që një numër i konsiderueshëm individësh nuk arrijnë të kristalizojnë detajet e të qenurit një lider në grup dhe jo një drejtues i grupit. Një drejtor i merr meritat për vete duke i përdorur të tjerët për të vënë në dukje superioritetin që zotëron ndaj tyre, ndërsa nga ana tjetër një lider i tregon njerëzve të tij rrugën e duhur, i motivon duke i vlerësuar si dhe njëkohësisht mundohet të jetë i sinkronizuar me të gjithë, duke menduar gjithmonë “NE mundemi!”

Do të theksoja faktin se termi lider nuk mund të haset vetëm në politikë. Përkundrazi, ky term mbart në veten e tij një spektër të gjerë të të qenit lider, veçanërisht në situatën, kur në një grup, gjithmonë është dikush, i cili spikat nga të tjerët duke vendosur pikat mbi ‘i’. Respektivisht lider mund të kemi në familje, art, sport, politikë, etj. Parimisht këta individë ecin gjithmonë “kundër” rrymës, duke vepruar dhe jo duke u pozicionuar, dhe kjo është një nga ato pjesët më të rëndësishme për të ndërtuar një “kështjellë” të një lideri me baza të forta.



Sipas autorit Hans Finzel: “Një lider i drejton njerëzit atje ku ata asnjëherë nuk do të mund të shkonin vetë.” Duke e analizuar këtë shprehje, mund të dalim në përfundimin se një lider gjithmonë tenton t’i kryejë objektivat në grup. Pa marrë parasysh postin që ai ka, vendosmëria për të përmbushur qëllimin e tij në grup, arrin të depërtojë egoizmin për të qenë ai i pari. Ndërkohë, pas Liderit janë dhe 999 të tjerë, të cilët kanë kontribuar me opinionet e tyre, për të dizajnuar një skelet brilant, i cili i

jep formë zgjidhjes së një problematike të caktuar.

Në ditët e sotme shumë njerëz e kanë të vështirë të dalin nga zona e komfortit dhe të marrin guximin për t’u angazhuar në trajnime apo evente, të cilat mund të jenë hapi i parë drejt suksesit. Në jetën e përditshme ndonjëherë je i kushtëzuar të ndjekësh turmën, edhe pse e di se do të ishte më mirë që turma të të ndiqte ty, sikur të ishe i vetmi planet, në të cilin do të mund të përballësh me këndvështrime plot ngjyra, kur më përpara ato kanë qenë të cekëta në një tunel me drita bardhë e zi.

E gjithë dija që ne akumulojmë nuk do të ketë vlerë në qoftë se nuk e ndajmë me personat e duhur apo sistematizojmë atë në mënyrën e duhur, ashtu si akordohen tingujt e një simfonie të famshme të Moxartit. Po në këtë mënyrë duhet të funksionojë dhe një lider me grupin e tij për të mos patur vakuume në gjithë procesin e bashkëpunimit mes tyre.

Të jesh lider kërkon shumë durim, përkushtim, mbështetje dhe një gërshtetim i të gjithave së bashku do të manifestonte atë që quhet “Arti i Leadershipit”. Një detaj që nuk mund të mungonte gjatë rrugëtimit të një lideri është koha. Mos harroni që koha ecën vetëm përpara, pa u ndalur! Në këtë mënyrë mund të personifikohet dhe një lider me vizion largpamës, që gjithmonë duhet të ecë përpara, pavarësisht sfidave, të zymtave që mund të shfaqen në ditët e bukura plot diell dhe freski pranverore.

Loridela Beqari



Edukim për fuqizimin e të rinjve

Ne synojmë të zhvillojmë njohuritë, aftësitë dhe të zgjerojmë mundësitë tona për suksese në jetë. Kjo ndërhyrje projektohet të zhvillojë njohuritë e të rinjve, duke ofruar një kombinim të jetës dhe të punësimit. Projektimi i ndërtimit të kapaciteteve janë fushat që lidhen me mjedisin e punës dhe mbështetjen e të rinjve për të kërkuar punë, me besim në njohuritë e tyre, me atë çfarë ata janë dhe çfarë duan të bëjnë.

Pjesë shumë e rëndësishme e projektit është ngritja e kapaciteteve të profesionistëve, lehtësimin e punësimit dhe për të ndikuar në politikat në nivel kombëtar duke përdorur një qasje nga poshtë lart. Zhvillimi i aftësive jetësore do të vazhdojë të përqëndrohet në fushat e identifikuar vitin e kaluar me qëllim thellimin e aftësive në nivelin e kompetencave. Si fillim, planifikohet të jenë rreth 30 anëtarë, kryesisht nga gjimnazet e qytetit turistik dhe më pas aktiviteti do të marrë përmasa më të mëdha, duke u shtrirë edhe në rang rrethi. Rritja e pjesëmarrësve do t'u mundësojë anëtarëve të vjetër aplikimin praktik të aftësive të fituara në lidhje me ndërtimin e ekipit, marrjen e vendimeve dhe tolerancës. Formimi i të rinjve

do të realizohet përmes trajnimeve të tyre. Metodologjia e kurrikulave është një kombinim i aktiviteteve me reflektimet personale dhe grupe që ndihmojnë në praktikë me pjesë të vogla të rugës për planet individuale të jetesës.

Në mënyrë që të rinjtë të angazhohen plotësisht dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive lypet domosdoshmëria e miratimit të prindërve. Ne duam të punojmë ngushtë me prindërit për të ndërtuar një kulturë të besimit dhe të të dëgjuarit, për të mos i parë me skepticizëm aspiratat e të rinjve për të ardhmen, por përkundrazi duke i mbështetur sa më shumë ata.

Objektivat e projektit do të synojnë edhe mësuesit, përgjegjës për çështjet e zhvillimit të karrierës, mësimit për t'i trajnuar ata në qasjet më të mira dhe mënyrat praktike për të ndihmuar të rinjtë të marrin vendime të dobishme për të ardhmen e tyre.

Si pjesë e zhvillimit të vlerave, përgjegjësisë sociale, të rinjtë do të nxiten më tej për të menduar rreth aktiviteteve dhe qasjet për të përfshirë grupet më të pafavorizuara në shoqëri, duke futur elementë të punës në komunitet dhe vullnetarizmin.



Kjo sipërmarrje do të kërkojë vazhdimësinë e mbështetjes dhe bashkëpunimin e mirë të Bashkisë së Pogradecit, autoriteteve lokale të arsimit dhe të punësimit, bizneseve lokale dhe komunitetit mbarë. Partnerë të rinj strategjikë, për dy vitet e ardhshme, do të jenë organizatat ndërkufitare, autoritetet rajonale në Pogradec, Shoqata "Unë, Gruaja", etj.

Për risitë e reja në lidhje me hapjen dhe funksionimin e kësaj qendre, jeni të lutur të na ndiqni në numrin e radhës!

Diter Bitri

Jeta boshe e të rinjve



Probleme sociale?! Shpesh mendojmë se një vendi vogël s'ka shumë problematika, por ato janë aq të dukshme sa ndonjëherë e neglizhojmë ekzistencën e

tyre. Por, për sa kohë Pogradeci ka një masivitet të rinjsh, atëherë edhe problematikat e kësaj grupmoshe do të jenë të shumta. Por a jemi ne aq të ndërgjegjshëm sa t'i shohim dhe kuptojmë problematikat e të rinjve? Dhe më pas, pse jo, të bëhemi pjesë e zgjidhjes?

Fillimisht, le të parashtrijmë disa prej problematikave që i shoqërojnë të rinjtë sot.

Praktikat mësimore: Nuk di se sa prej shkollave të qytetit tonë kanë një vegël muzikore për të zhvilluar lëndën e muzikës. Nuk e kuptoj se si mund t'i mësojnë nxënësit notat dhe tingujt e tyre, pa praktikë dhe praninë e të

paktën një vegle muzikore?! E në mos kjo nuk financohet dot nga organet kompetente, pse nuk krijohen projekte të ndryshme financimi: nga nxënësit e shkollave (prindërit) apo edhe nga bizneset e qytetit. E pra, me mundësitë e publicitetit dhe rrjeteve sociale, sot mund t'i krijojmë vetes hapësirat për të ngritur dhe transmetuar zërin dhe mesazhin tuaj atje ku duhet.

Kimia dhe biologjia: A nuk kanë nevojë këto lëndë për praktikë mësimore? Sa nga ju kanë shkuar në laboratorët e shkollës, nëse ka ende një të tillë? Edhe nëse ndonjë gjimnaz ka disa mjete laboratorike, janë aq të vjetra sa ke frikë t'i prekësh se mos dëmtohen.

Fizkultura: Sa qejf e kemi të gjithë këtë lëndë? Jo vetëm që vendos balancën e ngarkesave mësimore, por edhe konsiderohet si orë pushimi.

Përse të mos përkushtohemi, në bashkëpunim me organizatat sportive të qytetit, që të bëjmë një kalendar aktiviteteve sportive, pa penguar procesin mësimor, p.sh. të organizojmë një kampionat, në rang qyteti dhe qarku, në futboll, basketboll apo volejball?

Edukata: Nuk e di për ju, por mua më rastis të shoh çdo ditë të rinj e të reja dhe jo vetëm, që mbeturinat i hedhin kudo, përveçse në vendin e duhur. Çdo ditë dëgjoj nga të rinjtë fjalor të papërshtatshëm dhe një regjistër shumë të ulët komunikativ. Nuk mendoni se kjo sjellje po rëndohet dita-ditës? E pse të mos organizohet një orë mësimore shtesë, siç është Këshillimi i Karrierës, të jetë edhe Edukata Qytetare, por me peshën e duhur dhe çdo vit?

E së fundmi, të gjitha këto probleme mos vallë vijnë sepse mungon nxitja, motivimi, sepse nuk krijohen hapësirat dhe mundësitë e duhura? Në qytetin tonë të vogël ka shumë të rinj të talentuar, të cilët nuk kanë hapësirat e duhura për t'i zhvilluar dhe përsosur aftësitë apo hobet e tyre. Shumë të rinj kanë talent dhe dhunti në pikturë, muzikë, në shkencat kompjuterike, në sporte të ndryshme, dhe që ata t'i aftësojnë këto talente mendoj se vendimi i duhur është hapja e një Qendre Rinore.

Le ta ngremë zërin së bashku duke filluar nga ky buletin!

Simela Gegprifti

Buzëqeshja e tokës varet nga ne



Një pjesë kyçe e kulturës sonë jetësore është marrëdhënia me natyrën. Njeriu frymëzohet nga natyra, krijon një kulturë, e cila më pas ndikon në natyrën që vetë e frymëzoi. Kjo spirale vazhdon prej shekujsh dhe përcakton edhe linjën e zhvillimit njerëzor e mjedisor. Në këtë këndvështrim, mund të dilet në konkluzionin se natyra dhe kultura e njeriut janë në simbiozë me njëra tjetrën.

Për fat të keq, kjo marrëdhënie ndërveprimi është gjithmonë e më tepër në degradim, ku simbioza e dikurshme po tretet duke ia lënë vendin një kulture njerëzore, e cila po sundon gjithnjë e më shumë natyrën, duke humbur harmoninë me të.

E si mund të ndodhë diçka e tillë



në një qytet si ky i yni, të cilit Zoti i ka falur peizazhin më të bukur natyror?! Përkujdesja për të patur një mjedis të pastër dhe cilësor tregon jo vetëm një shkallë të lartë ndërgjegjësimi dhe përgjegjësie për vlerat që duhen mbrojtur dhe trashëguar ndër brezat e ardhshëm, por edhe një nivel të lartë qytetarie dhe edukimi për të rinjtë. Për të nxitur sa më shumë qytetarët, që të mbrojnë cilësinë e mjedisit të tyre, shoqata, organizata e forume të ndryshme në qytetin tonë kanë zhvilluar disa aktivitete me fokus mjedisin. Një nga shembujt më të mirë të tyre është shoqata "Unë, Gruaja". UG në bashkëpunim me Qendrën Rajonale të Mjedisit ka ndërmarrë një nismë: "Së bashku një sy për mjedisin!" nën moton: Redukto! Ripërdor! Riciklo!

Nuk mund të pastrohet një qytet i tërë vetëm me veprimtaritë e shoqatave dhe organizatave. Të gjithë qytetarët duhet të ndërgjegjësohen. Duke u nisur nga ky parim, Forumi i Rinisë Eurosocialiste të Rrethit të Pogradecit – FRESSH ndërmori një nismë për pastrimin e qytetit, duke u përqëndruar te vija

bregliqenore. Kësaj nisme iu bashkuan nxënës të shkollave të ndryshme të qytetit, por edhe grupi i trajnimit 'Bëhu Lider', të pajisur me mjetet e nevojshme për pastrimin. Objektivi kyç i aktivitetit ishte të pastrojmë duke ndërgjegjësuar edhe të tjerët. Një rol të madh luajti edhe publikimi në televizionin lokal Sot7 nga gazetari Ilir Shyta, i cili i kushtoi një kronikë televizive kësaj sipërmarrjeje rinore.

Të tjera aktivitete të tilla janë organizuar nga shoqata të ndryshme për t'i bërë njerëzit të kuptojnë se ata janë zotëruar dhe përfitues reciprokë të mjedisit që i rrethon. Si të tillë, duhet që veprimet e tyre t'ia adresojnë vetes dhe më pas të mendojnë sesi ndikojnë ato në mjedis. Të njëjtën kanë menduar edhe nxënësit e klasës së 10-a të gjimnazit "M. Çollaku", në bashkëpunim me mesuesen kujdestare znj. Shpresa Nikolla, kur ndërmori projektin për krijimin e një parku përballë shkollës. Kjo iniciativë ka si qëllim krijimin e një sipërfaqeje të gjelbër për të krijuar një ambient sa më të këndshëm, jo vetëm për



shkollën, por edhe për komunitetin përreth. Tashmë, në fund të realizimit të projektit të tyre, nxënësit ndjehen të lumtur, sepse kanë dëshmuar vërtet se me përpjekje dhe dëshirë mund të arrihet gjithçka.

Ne duhet të jetojmë në harmoni me natyrën, si përfitues të tërësisë së kushteve natyrore, duhet të kujdesemi për të dhe të shfrytëzojmë me efikasitet të mirat e saj, përndryshe ajo na ndëshkon ne dhe brezat që do të vijnë. Është koha të veprojmë! Buzëqeshja e tokës varet nga ne.

Enxhi Kaso



Nevojat dhe problemet e të rinjve

Shqetësimi më i madh për të rinjtë e kohëve të sotme është papunësia. Niveli i lartë i kësaj të fundit mes të rinjve është aktualisht një ndër fenomenet më shqetësuese në Europë dhe kriza duket se e ka thelluar këtë problem edhe në Shqipëri. Papunësia mes të rinjve është pothuajse dy herë më e lartë se papunësia mesatare në ekonomi dhe për brezin e parë të të rinjve deri në moshën 24 vjeç, shkalla e papunësisë arrin në pothuajse 28%.

Sot ndodh që të rinjtë e diplomuar, në pamundësi të gjetjes së pozicionit të punës konform specializimit, përfundojnë duke konkurruar për roje dhe shoferë. Përveç kësaj, ka mungesë të kualitetit të jetës publike dhe mbesin në mëshirë të kafeneve, që të mbushin kohën dhe akoma më keq, në pritje për të gjetur paratë e një kafeje ose t'jua paguajë dikush tjetër. Konstatoj nga eksperiencia personale se nuk ka prespektivë punësimi, të rinjtë kanë rënë pre e një jete të dobët, normalisht, sepse

gjithçka iu është mërzhitur.

Shumë prej nesh e shohin më të arsyeshme për të emigruar jashtë shtetit, me idenë që mund të gjejnë një zgjidhje, një punë, sepse aty ku ndodhen nuk ju dëgjohe mendimi, ose nuk ka vend për ta. Nevojat e të rinjve në Shqipëri, për mbështetje nga institucionet, qoftë qendrore, qoftë komunale, janë të mëdha, ndërkohë që buxheti i ndarë për ta, as për së afërmi nuk i plotëson nevojat dhe kërkesat e të rinjve. Të rinjtë e sotëm kanë nevojë për një qendër rinore, ku të kenë mundësi të angazhohen dhe aktivizohen në hapësirat që fal komuniteti.

Qenia, ose krijimi i përshtypjes se janë jashtë realitetit, është një nga problemet e mëdha. Ata nuk i kuptojnë rrethanat, kohën apo vendin ku jetojnë. Çdo ditë dëgjojmë për incidentet të shkaktuara nga të rinjtë e sotëm. Shumica e vjedhjeve, grabitjeve dhe sidomos trafiku dhe përdorimi i lëndëve narkotike, zhvillohet

kryesisht nga grupmoshat e reja, dhe kjo ndodh për shkak të papunësisë, si edhe nevojave të cilat nuk iu plotësohen. Madje, të rinjtë e sotëm, në raport me të kaluarën, janë më të rrezikuar ndaj sëmundjeve, kjo për shkak të konsumit të madh të alkoolit, drogave, etj.

Problem tjetër është se rinia e sheh partinë si kyçin e zgjidhjes së jetës së tyre dhe ambicieve që kanë, duke krijuar pikëpamjen e tyre ndaj jetës, e cila për fat të keq është shumë larg prej së vërtetës dhe realitetit.

Duhet të mos harrojmë se rinia ka edhe sfida të ndryshme me të cilat përballet dhe njëra prej tyre është që të shkollohen. Por a marrin nga sistemi arsimor atë që duhet t'iu ofrojë? Ata duhet të bëjnë trefishin e përpjekjeve për të marrë atë që ju nevojitet, duhet të luftojnë shumë që të meritojnë një vend pune.

Nëse do t'i përmbledhim gjithë këto probleme në një emërues të



përbashkët, absolutisht do e kisha emëruar si mungesa e busullave morale që ka kjo rini, sepse të rinjtë ndjehen inferioritet ndaj vetes dhe ndjenja e inferioritetit është ndjenja më e keqe. Në rastet kur njeriu ndjehet inferior kërkon ta rigjejë veten dhe më pas, ose do kalojë në krizë depresioni, do të detyrohet të largohet, ose do ta ndërtojë jetën e tij mbi bazën e perceptimeve të fjalëve të të tjerëve, por asnjëherë mbi njohjet e tij personale dhe përvojës pozitive.

Krisela Toska

Psikologji



Çdo ditë e më shumë dëgjojmë për probleme të ndryshme të adoleshentëve, jo vetëm në jetën e tyre private, por edhe në atë shkollore. Dihet tashmë se çdo shkollë ka dhe psikologun/en e saj, por sa e nevojshme është prania e psikologut në shkollë?

-Si fillim ju falenderoj që pranuat të jepni këtë intervistë.

Znj.Ardita: Faleminderit juve, sepse është në interesin tonë të mund të flasim hapur për problemet tona, kështu mund të gjejmë dhe zgjidhje më lehtë

-Si mendoni ju, a i nevojitet një psikologe një institucioni shkollor, ku adoleshentët të kenë një "derë" të hapur për çdo problem që mund t'i shoqërojë ata?

Znj.Ardita: Nuk i nevojitet, e kanë shumë të domosdoshme, sidomos tani kur duket sikur askush nuk të kupton, ose qoftë edhe të interesohet për ekzistencën tënde.

-Prania e një personi që të dëgjon dhe drejton është një nevojë. A ngurrojnë këta adoleshentë të marrin një hap për të shfaqur problemet e tyre?

Znj.Ardita: Po, ngurrojnë shpesh.

-Pse ndodh kjo?

Znj.Ardita: Për shumë arsye. Them se frika ndaj paragjykitimit është ajo më kryesorja.

-Çfarë jeni në gjendje të bëni ju për të thyer tabunë e mendimeve të këtyre

adoleshentëve?

Znj.Ardita: T'u ofrojmë gjithë profesionalizmin tonë, t'i dëgjojmë, të besojmë tek ata me qëllim që edhe ata të mund të besojnë te ne.

-Të shpresojmë që kjo gjë të realizohet e të përcillet si një mesazh i mirë tek të gjithë ata adoleshentë që ngurojnë të hapin dyert në zyrat e psikologëve.

Znj.Ardita: Shpresa nuk është e mjaftueshme, adoleshentët janë shumë të brishtë, prandaj mbështetja është e domosdoshme. Mos harroni, në qoftë se nuk mund të gjeni një fjalë të ngrohtë në familjen tuaj, një dorë që t'ju ndihmojë në shoqëri, dijeni se do jetë gjithmonë një derë e hapur për ju, ju nuk jeni vetëm!

-Ju falenderoj për këto fjalë nga zemra, për këtë shpresë dhe shtysë. Faleminderit për intervistën dhe shumë suksese në punën tuaj në vazhdim.

Znj.Ardita: Falënderimet më takojnë mua. Thellësisht shpresoj që këto fjalë të kenë kthyer buzëqeshje në fytyra të vetmuara.

Duke marrë parasysh përgjigjet e psikologes në qytetin e Korçës, vendosëm që të intervistonim gjithashtu edhe ish-psikologun e shkollës "Muharem Çollaku" -Pogradec, znj. Vasiana Bardhushi.

-Znj. Vasiana përshëndetje! Ju falënderoj shumë që na dhatë mundësinë për këtë intervistë, e cila sado pak do të ndihmojë në krijimin dhe zhvillimin e këtij koncepti tek adoleshentët.

Znj.Vasiana: Ju faleminderit, kënaqësia është e imja.

-Si mendoni ju, a i nevojitet një psikologe një institucioni shkollor, ku adoleshentët të kenë një "derë" të hapur për çdo problem që mund t'i shoqërojë ata?

Znj.Vasiana: Po, sepse të gjithë kanë nevojë të flasin me dikë për të shkëmbyer mendime dhe për të marrë këshillime, trajtime dhe terapi



të ndryshme. Është më e lehtë që personi të flasë me dikë që nuk e njeh.

-Prania e një personi që të dëgjon dhe drejton është një nevojë. A ngurrojnë këta adoleshentë të marrin një hap për të shfaqur problemet e tyre?

-Znj.Vasiana: Ka nevojë akoma për sensibilizim. Për çdo gjë ka rëndësi psikologu, secili e shfaq veten e tij para nxënësve, varet sa besim jep tek ata.

-Por, pse ndodh kjo?

-Znj.Vasiana: Kjo ndodh, sepse psikologjia është shkencë moderne dhe kjo gjë është akoma e re për Shqipërinë, e cila është akoma në tranzicion. Konceptohet që psikologu është për të menduarit.

-Çfarë jeni në gjendje të bëni ju për të thyer tabunë e mendimeve të këtyre adoleshentëve?

-Znj.Vasiana: Asgjë më shumë se të vërtetën që parashikon kjo shkencë, që shërbimi i një psikologu (i mi) duhet t'i japë nxënësit besim, vërtetësi, pra duhet të jesh i drejtë me nxënësin.

-Të shpresojmë që kjo gjë të realizohet e të përcillet si një mesazh i mirë tek të gjithë ata adoleshentë që ngurrojnë të hapin dyert në zyrat e psikologëve.

-Znj.Vasiana: Në qoftë se do të shtoheshin psikologët që kanë dëshirë të punojnë siç duhet, kjo gjë do të ishte akoma më e lehtë për t'u realizuar.

-Ju falënderoj për këto fjalë nga zemra, për këtë shpresë dhe shtysë. Faleminderit për intervistën dhe shumë suksese në punën tuaj në vazhdim!

-Znj.Vasiana: Falënderimet më takojnë mua që më dhatë mundësinë të jap mendimin tim në lidhje me këtë çështje dhe pse jo, sensibilizimin e gjithë atyre të rinjve, të cilët stepen para psikologut.

P.s. Kjo intervistë do të vijojë me pyetje në drejtim të nxënësve, prindërve dhe cilitdo qytetar të interesuar mbi këshillimin me psikologun.

Amadeo Hazizaj

Redaksia:

1. Diter Bitri (Kryeredaktor)
2. Amadeo Hazizaj (Designer)
3. Zhuljen Manellari
4. Ina Beçoku
5. Enxhi Kaso
6. Sergej Meçe (Korrektor letrar)
7. Simela Gegprifti
8. Loidela Beqari
9. Krisela Toska
10. Dorian Leka (Mentor Grupi)
11. Afroviti Gusho (Drejt. projekti)



Projekti: Më shumë të rinj në Leadership nëpërmjet pjesëmarrjes Qytetare.

Ky projekt mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë. Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë material nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.